

# Kalon vetingun gjyqtarja që rrëzoi akuzat ndaj Tahirit



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka konfirmuar në detyrë gjyqtaren e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Flora Hajredinaj.

Hajredinaj është një prej tre gjyqtareve të trupës së gjykoj çështjen e ish-ministrit Saimir Tahiri.

Në shtator 2019, ajo bashkë me Irena Gjokën dhe Ardit Mustafajn, [çliruan](#) ish-Ministrin të Brendshëm Tahiri nga të gjitha akuzat e prokurorisë për trafik droge dhe e dënuan atë me 5 vite burg për shpërdorim detyre.

Vendimi u mor të premtën nga trupa e përbërë nga Brunilda Bekteshi, Olsi Komici dhe Firdes Shuli.

Hajredinaj u konfirmua në detyrë megjithëse gjatë hetimit administrativ, KPK gjeti probleme me justifikimin e pasurisë në të paktën dy raste.

Gjyqtarja ka deklaruar si burime të ardhurash për blerjen e një apartamenti një kredi bankare në vlerën 4.8 milionë lekë, kursime bashkëshortore 1.6 milionë lekë dhe dhuratë nga vjehri 40 mijë euro.

Sipas KPK-së, gjyqtarja nuk ka mundur të justifikojë me burime të ligjshme kursimin e 1,6 milionë lekëve. Po ashtu KPK ngriti dyshime nëse vjehri i saj ka pasur mundësi për të kursyer dhe dhuruar 40 mijë euro.

Gjyqtarja tha se familja e bashkëshortit të saj kishte të ardhura nga qiratë e dy lokaleve në qytetin e Bajram Currit dhe nga puna e djemve në emigrim, por nuk kishte dokumentet e plota për të vërtetuar këtë gjë.

Pavarësisht problemeve me deklarimin e pasurisë, KPK vendosi konfirmimin e saj në detyrë.